



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Diskutimi i kërkesës së kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për caktimin e datës së seancës plenare për zhvillimin e mocionit me debat dhe miratimin e projektrezolutës për këtë çështje.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Nyslim Murizi -	Zëvendëskryetar i Kuvendit
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Nimet Musai -	Kryetar i Grupit Parlamentarë të Pavarur
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat / Kryetare e Komisionit për Integrimin European
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Enver Rroshi -	Kryetar i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Fatjona Dhimitri -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Klodiana Spahiu –	Zëvendëskryetare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
Senida Mesi -	Zëvendëskryetare e Komisionit për Integrimin European
Ralf Gjoni –	Zëvendëskryetar i Komisionit për Politikën e Jashtme
Halit Valteri -	Zëvendëskryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Mungojnë:

Arben Ahmetaj - Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

Marrin pjesë:

Mimoza Pano - Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Fillojmë mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve.

E thirra këtë mbledhje, pasi është depozituar një mocion me debat nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zoti Balla, për zhvillimin e një debati për çështjen e shfuqizimit të dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve për pushtetin vendor. Ky mocion, sipas rregullave, shoqërohet edhe me një projektrezolutë. Mocioni bazohet në nenin 98 të Rregullores dhe nga ana formale e procedurale i plotëson të gjitha kushtet që përcakton ky nen. Ky mocion është firmosur nga nismëtari, i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe është paraqitur me shkrim.

Duke e parë në këtë këndvështrim, e thirra këtë mbledhje të Konferencës së Kryetarëve sipas nenit 98, pika 2 e Rregullores, që parashikon se Kryetari i Kuvendit, brenda tri ditëve nga paraqitja e mocionit, thërret Konferencën e Kryetarëve për të vendosur datën e zhvillimit të mocionit në seancën plenare.

Kush ka ndonjë propozim për datën e zhvillimit të mocionit?

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Zoti Kryetar, duke vlerësuar rëndësinë e çështjes, për të cilën, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, përmes meje, si kryetar, ka kërkuar mbajtjen e këtij mocioni, për faktin se akti i Presidentit të Republikës është i paprecedentë dhe diskutimi i një çështjeje me kaq rëndësi në Kuvendin e Shqipërisë është i domosdoshëm, do të propozoj që ky mocion me debat të zhvillohet në seancën më të afërt të Kuvendit, që do të thotë në datën 13 qershor 2019, pra të enjten që vjen.

Gramoz Ruçi – Çfarë mendojnë zotërinjtë e tjerë përfaqësues të dy grupeve parlamentare?

Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Zoti Kryetar, e diskutuam paraprakisht dhe mendojmë se grupi opozitar ka dëshirë dhe do të shikojë mundësinë që, brenda orës 14:00 të ditës së sotme, të bëjë kërkesën për një mocion me debat. Kjo çështje do të ketë pothuajse të njëjtin objekt, por për arsye se është shumë sensitive dhe ka konsekuenca të larta politike, nuk është një gjë e lehtë, duke marrë parasysh që secili mund ta argumentojë në mënyra të ndryshme aktin e Presidentit. Mendoj se ne duhet të bëjmë propozimin tonë për mocionin me debat. Kërkesën do ta bëjmë sot. Do të mundohemi ta bëjmë kërkesën para orës 14:00, por nëse nuk e arrijmë dot, do të shikojmë ndonjë mënyrë për t'iu bashkuar këtij mocioni.

Nimet Musaj – Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Kjo që po ndodh këto ditë është një nga ngjarjet më të rëndësishme. Normalisht, duke u mbështetur edhe në Rregullore, ditën e enjte, patjetër që duhet të zhvillohet ky debat. Duke mbështetur (me aq sa patëm mundësi, 5 minuta më parë) edhe kolegen, ndoshta duhet të gjejmë modulën normal, që ky debat të jetë konstruktiv dhe real për ditën e enjte, në mënyrë që edhe vendimmarrja të jetë konstruktive dhe reale.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Datën e...

Të lutem, rezoluta nuk diskutohet këtu! Rezoluta është objekt i diskutimit të diksutantëve, i bërjes së amendimeve në seancë e të tjerë.

Taulant Balla – Zoti Kryetar...

Gramoz Ruçi – Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Me sa kuptova, zonja Hajdari nuk ka ndonjë gjë me kërkesën e grupit tonë, por në mënyrë racionale mendon të ketë një kërkesë, që për nga objekti mund jetë e përafërt dhe të zhvillohet një debat. Në rastin tonë ishte planifikuar 4 orë, le të themi, të bëhet 5 ose 6 orë. Kjo është ideja. Domethënë, të ketë ...

Praktikisht, ju jeni dakord me kërkesën tonë.

Gramoz Ruçi – Shiko, ka diçka, siç e kuptova unë.

Në sens, kërkesa juaj për mocion me debat është për të njëjtën çështje? Për të njëjtën çështje. Atëherë, sipas Rregullores së Kuvendit, kur ka kërkesa për të njëjtën çështje, ato zhvillohen bashkë. Ju mund të paraqisni edhe kërkesë për mocion me debat, por ato do të bëhen bashkë, ose mund të keni ndonjë mundësi tuajën për rezolutën apo për pika të veçanta të rezolutës dhe mund t'i paraqisni më vete dhe, kur të vijmë te hedhja në votim, pikat e rezolutës do të merren një nga një. Në fillim hidhen ato që janë bërë jashtë nismëtarit, domethënë fillon nga propozimet tuaja dhe vazhdojnë deri te miratimi në tërësi i rezolutës.

Atëherë, e mbyllim me konsensus çështjen e zhvillimit të mocionit me debat, që do të jetë pikë e parë e rendit të ditës në seancën e ditës së enjte.

Për sa i përket kohës së debatit, ka mendime?

Ulsi Manja – Nëse do t'i lëmë pothuajse shumicën e kohës mocionit ditën e enjte, ose nëse nuk do të kemi çështje të tjera në rendin e ditës, minutazhi ...

Gramoz Ruçi – Rendi i ditës, që ta dini, në kushtet që nuk kishte dalë kjo, ishte i gjerë dhe ka parashikuar jo pak, por mbi 13-14 çështje, por ndoshta mund ta zvogëlojmë në kuptimin që kemi dy raportime, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, që mund t'i shtyjme, dhe një interpelancë me ... Kush ka kërkuar interpelancë?

Taulant Balla – Lefter Maliqi me ministrin e Energjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gramoz Ruçi – Zonja Hajdari, kërkuat fjalën?

Ndizeni mikrofonin!

Rudina Hajdari – Mendoj se nuk duhet të shtyhet pika për raportin e prokurorisë, sepse, duke marrë parasysh edhe informacionet që kanë dalë javët e fundit, duhet shqyrtuar në parlament. E di që është pikë e nxehtë për maxhorancën, por duhet diskutuar. Nuk besoj se duhet shtyrë, pasi do të dukej si diçka që ne nuk po e marrin parasysh. Shumë prej nesh, të them të drejtën, jemi përgatitur për këtë pikë. Mendoj se mund të shtyjme gjëra të tjera.

Taulant Balla – Në fakt, në historinë 27-vjeçare të parlamentarizmit shqiptar nuk ka ndodhur një debat i tillë më parë dhe fokusimi i secilit prej nesh do të ishte në rëndësinë e zhvillimit të këtij debati. Të paktën, në praktikë parlamentare, të gjithë ne që jemi këtu, patjetër do të jemi pjesë e këtij debati dhe do të kishim një kohë prej 5 orësh, që, sipas Rregullores, ndahet proporcionalisht mes opozitës dhe maxhorancës. Në çdo rast, qoftë raportimit që përmend zonja Hajdari, apo raportime ose çështje të tjera, nuk janë më të rëndësishme se ky debat, sepse ajo që ka ndodhur lidhet me përpjekjen e ndokujt që të marrë autoritete që i ka vetëm Kuvendi i Shqipërisë. Dua ta kujtoj në Konferencën e Kryetarëve për të qenë pjesë e procesverbalit të kësaj mbledhjeje që Republika e Shqipërisë është republikë parlamentare, jo presidenciale. Do të kërkoja mirëkuptimin e të gjithëve që kjo seancë të jetë e dedikuar ekskluzivisht kësaj çështjeje. Patjetër që ne kemi mundësinë të bëjmë edhe të hënën e ardhshme apo të premten, nëse ju doni, një seancë tjetër normale, por të jemi të gjithë dakord që... Për fat të mirë, duke ju falënderuar të gjithëve, parlamenti është në funksion të plotë, grupet e opozitës kanë marrë të gjitha detyrat që u takojnë, por është në rëndësinë e institucionit që ky debat të jetë për këtë çështje. Patjetër që bie dakord me ju që edhe çështjet e tjera janë të rëndësishme, por edhe në strategjinë e komunikimit publik, harrojeni se do të kishte vëmendje publike ndonjë

çështje tjetër në atë seancë. Edhe unë e kam merak që të kemi një debat disa orësh edhe për çështjen që përmend zonja Hajdari, sepse është një raportim normal i Kuvendit të Shqipërisë. Madje edhe për raportimin i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesave do të doja të kishim debat dhe diskutim se si politikanë të caktuar në këtë vend e kanë nisur karrierën me duar në xhepa dhe aktualisht janë me qindra milion pasuri, por mendoj që ky është një moment i rëndësishëm për t'u fokusuar te kjo.

Zoti Kryetar, propozimi im, për të qenë konciz, është që debati të jetë 5 orë, proporcioni i minutazhit midis grupeve të opozitës të përcaktohen në varësi të numrit. Ne kemi të gjithë dashamirësinë që kjo të mos jetë një gjë e ndarë, por t'u japim mundësinë kryetarëve të grupeve të opozitës, kryetarëve të komisioneve, folësve me peshë brenda opozitës, sikurse edhe brenda maxhorancës për të folur. Për t'ua shpjeguar deputetëve të opozitës, dua t'ju them se koha nuk është e përcaktuar, dikush mund të flasë 20 minuta dhe dikush tjetër 2 minuta.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Zoti Kryetar, së pari, është çështje për t'u diskutuar se cila pjesë është më e rëndësishme, sepse unë e perceptoj ndryshe dhe mendoj se raportimi i Prokurores së Përgjithshme është po aq i rëndësishëm. Fakti që Presidenti ka bërë një shkelje të madhe ligjore dhe kushtetuese patjetër që është diçka serioze, por, në fakt, ishte diçka e pritur nga të gjithë ne, nuk ishte e papritur dhe në fund debati që do të bëhet do të shkojë deri aty, që ky njeri ka shkelur Kushtetutën dhe e ka bërë me vetëdije, madje, deri diku, ai është vetëshkarkuar me atë gjest që ka bërë. Unë nuk shikoj që kjo temë ka kaq shumë debat, sepse deri aty shkon. Fakti që ne kemi një Prokurore të Përgjithshme që nuk ka bërë absolutisht asgjë dhe shumë nga ata njerëz që dalin aty jashtë janë të shqetësuar prej faktit që kjo prokurore ka vite të tëra që ulet mbi ato dosje të rëndësishme që implikojnë njerëz të lartë, të cilët shpërdorojnë detyrën e tyre dhe kanë lidhje serioze me krimin tregon se janë çështje me interes të lartë publik dhe nuk mendoj se kjo është një temë që duhet shtyrë. Ajo ka rëndësinë dhe peshën e vet në interesin publik.

Gjithsesi, unë jam tolerante dhe mund të zhvillojmë një seancë tjetër, por jo ta shtyjmë shumë këtë raportim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne, zakonisht, kur bëjmë seanca, i bëjmë më të gjata se 4-5 orë dhe nuk është ndonjë çudi e madhe. Ne kemi edhe 4 seanca të tjera dhe vëmendja fillon e bie pas muajit qershor, sepse ka aktivitete të tjera të rëndësishme...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse mundemi, edhe sipas propozimit të zotit Balla, të kemi një seancë tjetër ditën e premte. Duhet njoftuar Prokurorja nëse është e gatshme të vijë ditën e premte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Projektligji “Për regjistrimin e biznesit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për projektligjin për procedurat tatimore, zoti Balla, a ka ndonjë urgjencë?

Ulsi Manja – Janë 5 projektligje 1 paketë, quhet paketa e projektligjeve që ka sjellë MONEYVAL-i, nuk kanë kaluar ende. Ne për 3 prej tyre jemi komision përgjegjës.

Gramoz Ruçi – Nuk i keni mbaruar?

Ulsi Manja – Jo, nuk i kemi mbaruar, sepse nuk kanë mbaruar komisionet për dhënie mendimi, por edhe ne sot kemi aftin e fundit.

Gramoz Ruçi – Të hiqen të 5-ta dhe të shtyhen për seancën tjetër.

Urdhëroni!

Fatjona Dhimtri – Faleminderit, zoti Kryetar!

Lidhur me kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë së Socialiste për mocion me debat, ne flasim tani për orët e debatit që do të marrim në seancën plenare, por lidhur me kushtetutshmërinë apo jo të aktit të dekretit të Presidentit shprehet vetëm Gjykata Kushtetuese. Edhe pse një dekret, mund të jetë i gabuar, por nuk është antikushtetues, ka një gjykatë Kushtetuese, që vepron për këtë. Personalisht, shprehem kundër këtij mocioni. Një dekret i gabuar në formën e Kushtetutës, nuk është antikushtetues.

Gramoz Ruçi – Të lutem, këtu nuk diskutojmë përmbajtjen e mocionit, këtu jemi Konferencë Kryetarësh dhe diskutojmë në bazë të procedurave parlamentare kur do të zhvillohet mocioni, sa kohë duam për mocionin dhe më pas pikëpamjet, mendimet e tua, të tjetrit shprehen vetëm në seancë me diskutim dhe me votë. Dakord.

Pastaj nëse është te Gjykata Kushtetuese apo jo, duhet të dini që, sepse jeni edhe deputete e re, vetë Gjykata Kushtetuese është shprehur për këtë çështje, që nuk është kompetencë e saj. Atëherë, për kohën çfarë keni?

Urdhëroni!

Elisa Spiropali – E diskutova pak me edhe kryetarin grupit: në rast se paketa e MONEYVAL-it mund të kalojë para datës 20 do të ishte shumë mirë, përpara diskutimit për çeljen e negociatave me Shqipërinë.

Gramoz Ruçi – Për të gjitha këto çështje të bëhet gati komisioni në datën 20 që është seanca...

Elisa Spiropali – Prandaj kërkuam që të futej në datën 13, në mënyrë që të kalonte më përpara. Në qoftë se mund të kalojë në datën 20, do të ishte shumë mirë.

Gramoz Ruçi – I sillni më shpejt projektligjet dhe komisionet të shpejtojnë punën.

Elisa Spiropali – Në fakt, i kemi sjellë në kohë rekord dhe i kemi rakorduar.

Gramoz Ruçi - Ta mbyllë komisioni dhe në datën 20 të futen të gjitha për shqyrtim si paketë.

Elisa Spiropali – Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Ju lutem, për kohën, a biem dakord 5 orë? Sa kohë do të ketë maxhoranca, sa kohë do të ketë opozita dhe sa kohë do të kenë deputetët e tjerë, që janë jashtë grupimeve? Pra, sa i bie, sipas proporcioneve, 5-orëshi?

Mimoza Pano – 2 orë e gjysmë maxhoranca, 2 orë opozita dhe gjysmë orë deputetët jashtë grupeve parlamentare.

Gramoz Ruçi - Si e llogaritke kështu, 74 veta me 25 veta njësoj?! Si e bërë?

Rudina, sa minuta ju duhen juve për mocionin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – Zoti Kryetar, ne kemi 57% të vendeve në Kuvend, bashkë me 3 deputetë të pavarur që votojnë me ne, 79 vende në Kuvend që i bie 57%. 57% i 300 minutave i bie 170 minuta, 130 minuta i takojnë opozitës. Natyrshëm që në të dyja grupet parlamentare të opozitës, grupi demokrat dhe i ai i pavarur, numri i deputetëve është pak a shumë i ngjashëm.

Ne do të kemi një debat dhe duhet të jemi të tria grupet parlamentare të përgatitura, se deputetët e peregjistruar në grupe parlamentare janë 23 dhe secili prej tyre do të kërkojë të flasë, por ky është një mocion me debat dhe koha është e përcaktuar. Nëse do t'u linim secilit prej tyre nga një minutë, i thonë 23 minuta gjithsej, pra 130 minuta, u lëmë 30 minuta këtyre deputetëve dhe nga 50 minuta secilit grup parlamentar, 50 minuta grupi demokrat, 50 minuta grupi i pavarur dhe 170 minuta deputetët e grupit të maxhorancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le t'i ndajmë vetë, ne u themi që kanë 30 minuta, nëse regjistrohen të 23 secili ka nga një minutë, 6 prej tyre do të kenë 2 minuta.

Në Parlamentin Europian diskutimi më i rëndësishëm zgjat 3 minuta.

Gramoz Ruçi – Atëherë 50, 50, 170 minuta.

Debati është 5 orë?

Atëherë 50 minuta të dyja grupet e opozitës, 170 minuta grupi i maxhorancës dhe 30 minuta deputetët e pavarur sipas regjistrimit që do të regjistrojnë ata dhe koha, si për maxhorancën, si për opozitën, si për të pavarurit do të ndahet brenda kufirit të kësaj kohe. Për shembull, nëse grupi demokrat ka 50 minuta është e drejta e tyre të caktojnë numrin e diskutantëve dhe kohën për secilin prej tyre.

Taulant Balla – Për t'i shpjeguar diçka edhe opozitës: kini parasysh që anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe Kryeministri, janë në kohën e grupit tonë, pra në rastin e mocionit

me debat nuk aplikohet e drejta që, meqë foli Kryeministri do të flasë një përfaqësues i opozitës me të njëjtën kohë. Koha është e përcaktuar dhe nuk do të aplikohen nenet e tjera të rregullores për të drejtën e përgjigjes së opozitës.

Gramoz Ruçi – Nëse Kryeministri flet 1 orë, kjo 1 orë i zbritet mazhorancës nga koha e mbetur. Mazhorancës i mbetet më pas pjesa tjetër e kohës caktuar.

Taulant Balla – Zoti Kryetar, kam edhe diçka tjetër. Ndjesë anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve që insisto, por kërkoj edhe një herë mirëkuptimin që debatin për prokuroren ta zhvillonim ose të hënën ose maksimumi të enjten tjetër, me qëllim që të mbyllet seanca në orën 3 duke ditur që pjesa më e madhe jona ka planifikuar disa aktivitete elektorale. Në historinë e Kuvendit, gjatë kohë së zgjedhjeve vendore, zhvilloheshin maksimumi 1 ose 2 seanca, por ne jemi angazhuar që ta vijojmë normalisht punën e Kuvendit, nisur dhe nga nevoja që ka vendi, përfshirë edhe paketën, që përmendi zonja Spiropali, apo dhe Kodin Penal. Mund të zhvillojmë një seancë ditën e hënë paradite për çështjet e tjera edhe sikur të zgjatë 3 ore, por ama marrim 5 orë dhe bëjmë disa diskutime të qenësishme. Nuk besoj se për tri ditë do të ndryshojë rëndësia e kësaj çështjeje, pasi bie dakord me ju që është shumë e rëndësishme.

Gramoz Ruçi – Edhe ajo është çështje para rendit të ditës.

Taulant Balla – Faleminderit shumë!

Gramoz Ruçi – Vetëm se duhet të jenë gati edhe 5 ligjet, me qëllim që t'i kalojmë atë ditë!

Faleminderit! Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA